



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ Prot.

Ballsh, më ____ . ____ . 2022

Lënda: **Formulari i Njoftimit të Fituesit 2**

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK - TIRANË
(për publikim në SPE dhe buletin e njoftimeve publike)

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 2
(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)
BASHKIA MALLAKASTËR

Drejtuar: **“MUCA” shpk**, me NIPT K01421002H, me adresë qendrore sipas QKB: Tirane Vore
PICAR Autostrada Tirane-Durres, km.13, fshati Picar

*** * ***

Procedura e prokurimit: **“E hapur e thjeshtuar”**

Numri i referencës së procedurës: **REF-39183-08-18-2022**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje materiale për mirëmbajtjen e objekteve publike (shkolla, zyra, varreza etj.)”**, me fond limit **7,716,599** (shtatë milion e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë) **Lekë pa TVSH**

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.114, datë 22 Gusht 2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1. Operatori Ekonomik (OE) “MURATI” shpk**, me NIPT J66702413V, me ofertë ekonomike në shumën prej **6,630,800** (gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e tetëqind) **lekë pa TVSH.**
- 2. Operatori Ekonomik (OE) “AA&P” shpk**, me NIPT L61713009Q, me ofertë ekonomike në shumën prej **6,407,000** (gjashtë milion e katërqind e shtatë mijë) **lekë pa TVSH.**

3. **Operatori Ekonomik (OE) “ADENIS KASTRATI” pf**, me NIPT L51611004I, me ofertë ekonomike në shumën prej **7,705,100** (shtatëmilion e shtatëqind e pesëmijë e njëqind) **lekë pa TVSH**.
4. **Operatori Ekonomik (OE) “ARDIT 06” shpk**, me NIPT K63027403V, me ofertë ekonomike në shumën prej **6,895,000** (gjashtëmilion e tetëqind e nëntëdhjetë e pesëmijë) **lekë pa TVSH**.
5. **Operatori Ekonomik (OE) “ARTEO 2018” shpk**, me NIPT L82523203F, me ofertë ekonomike në shumën prej **7,495,900** (shtatëmilion e katërqind e nëntëdhjetë e pesëmijë e nëntëqind) **lekë pa TVSH**.
6. **Operatori Ekonomik (OE) “MUCA” shpk**, me NIPT K01421002H, me ofertë ekonomike në shumën prej **6,726,500** (gjashtëmilion e shtatëqind e njëzetë e gjashtëmijë e pesëqind) **lekë pa TVSH**.
7. **Operatori Ekonomik (OE) “MURATI D” shpk**, me NIPT K42003004T, me ofertë ekonomike në shumën prej **6,151,550** (gjashtëmilion e njëqind e pesëdhjetë e njëmijë e pesëqind e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH**.
8. **Operatori Ekonomik (OE) “VELLEZERIT KUKA” shpk**, me NIPT J6342344Q, me ofertë ekonomike në shumën prej **6,890,600** (gjashtëmilion e tetëqind e nëntëdhjetëmijë e gjashtëqind) **lekë pa TVSH**.
9. **Operatori Ekonomik (OE) “ZEQIRI” shpk**, me NIPT J67902827A, me ofertë ekonomike në shumën prej **7,190,000** (shtatëmilion e njëqind e nëntëdhjetëmijë) **lekë pa TVSH**.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyet:

1. OE “MURATI” shpk, me NIPT J66702413V, me ofertë ekonomike në shumën prej **6,630,800** (gjashtëmilion e gjashtëqind e tridhjetëmijë e tetëqind) **lekë pa TVSH**, **nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe **Oferta e tij nuk është e vlefshme** për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:
 - Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me furnizimet e ngjashme të mëparshme, pasi referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistem me emërtim “11-MURATI_SHPK_KONTRATE_E_NGJASHME_MALLRASH”, e vetmja kontratë e listuar që përmban vlerën e saj, është kontrata e nënshkruar me Bashkinë Mat, me Nr.Prot.4261, Datë 22.11.2019 me titull “Blerje materiale të ndryshme ndërtimi” me vlerë 1,520,000 lekë pa TVSH. Referuar kërkesës së përcaktuar në pikën 2.3.1., kontrata e ngjashme duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (*fondi limit 7,716,599 lekë pa TVSH*) e barazvlefshme me 1,543,320 lekë pa TVSH. Nga sa më sipër, rezulton se vlera e kontratës së paraqitur është më e vogël se vlera e kërkuar (1,520,000 lekë pa TVSH < 1,543,320 lekë pa TVSH). Kontrata me nr.2214 prot, datë 13.08.2019 (Drafti i Marrëveshjes Kuadër) dhe Kontrata nr.3588 prot, datë .../10/2019 nuk kanë të përcaktuar vlerën dhe nuk merren në

konsideratë. Gjithashtu nuk është paraqitur as vërtetimi përkatës i lëshuar nga enti publik për realizimin e suksesshëm të kontratës.

Në nenin 92, pika 3, të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor [...] vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit [...]”*.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga OE “MURATI” shpk nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.

- 2. OE “MURATI D” shpk**, me NIPT K42003004T, me ofertë ekonomike në shumën prej **6,151,550** (gjashtëmilion e njëqind e pesëdhjetë e njëmijë e pesëqind e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH**, skualifikohet nga kjo procedurë pasi është në kushtet detyruese për skualifikim, parashikuar nga neni 76, i Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”. Konkretisht, në pikën 3, gërma “dh”, të nenit 76, parashikohet se:

“3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

... dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;”.

Në interpretim të dispozitës së mësipërme, KVO i referohet procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale elektrike dhe për ndriçim publik”, me numër reference REF-13816-12-02-2021, zhvilluar në datën 13.12.2021, procedurë në të cilën “MURATI D” shpk është shpallur fitues, por është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës, pasi nuk ka paraqitur Formularin e Sigurimit të Kontratës brenda afatit të përcaktuar nga AK Bashkia Mallakastër.

- 3. OE “VELLEZERIT KUKA” shpk**, me NIPT J6342344Q, me ofertë ekonomike në shumën prej **6,890,600** (gjashtëmilion e tetëqind e nëntëdhjetëmijë e gjashtëqind) **lekë pa TVSH**, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe Oferta e tij nuk është e vlefshme për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi për kontratën e paraqitur në SPE me nr.5 prot, datë 11.03.2019, me objekt “Blerje materiale për investime që do të kryhen nga sektori i investimeve”, lidhur me Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse Roskovec, nuk është paraqitur vërtetimi përkatës i lëshuar nga enti publik për realizimin e suksesshëm të kontratës.

Në nenin 92, pika 3, të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor [...] vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit [...]”*.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga OE “VELLEZERIT KUKA” shpk nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.

- 4. OE “AA&P” shpk**, me NIPT L61713009Q, me ofertë ekonomike në shumën prej **6,407,000** (gjashtëmilion e katërqind e shtatëmijë) **lekë pa TVSH**, skualifikohet nga procedura në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1042/2022, datë 26.10.2022.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: “MUCA” **shpk**, me NIPT K01421002H, me adresë qendrore sipas QKB: Tirane Vore PICAR Autostrada Tirane-Durres, km.13, fshati Picar, se oferta e paraqitur, me vlerë totale prej **6,726,500** (gjashtëmilion e shtatëqind e njëzetë e gjashtëmijë e pesëqind) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Mallakastër, lagjja “18 Prilli”, Ballsh, sigurimin e kontratës në emër të AK **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Mallakastër** (duke qenë se procedura është zhvilluar për nevoja dhe llogari të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallakastër dhe kontrata do të nënshkruhet me këtë të fundit) sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do të ndërmerren veprimet përkatëse, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak):

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*): Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1042/2022, datë 26.10.2022

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës: (*nuk është e aplikueshme*)

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ**

Zamir Malasi